



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.98/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rrustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit "Komuna e Pejës", me seli në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit [D.S.G], avokate nga Prishtina, kundër të paditurës ["H..."] sh.a., me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [F.F] nga Peja, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.47/17,të datës 11.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.11.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit "Komuna e Pejës", me seli në Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.47/17,të datës 11.12.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit "Komuna e Pejës", me seli në Pejë, e paraqitur kundër të paditurës ["H..."] sh.a., me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të shpërthimit të gypit të ujësjellësit paditëses t'ia kompensojë shumën e mjeteve në lartësi prej 54,285.50€, me kamatë ligjore në shkallën prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 30.08.2016, e deri në pagesën definitive brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, "Komuna e Pejës" për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoje ankesën e paditësit, duke e prishur aktgjykimin e atakuar dhe duke e aprovuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ose duke e aprovuar si të bazuar këtë ankesën dhe duke e prish aktgjykimin e atakuar dhe këtë çështje ta kthen në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhe se Padiësi Komuna e Pejës”, me seli në Pejë, me datën 09.02.2017 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës [“H...”] sh.a., me seli në Pejë, për shkak të kompensimit të dëmit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e padiësit dhe të detyrohet pala e paditur që në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të shpërthimit të gypit të ujësjellësit padiëses t’ia kompensojë shumën e mjeteve në lartësi prej 54,285.50.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se pala padiëse dhe e paditura kanë qenë në raport juridik detyrimor nga kontrata me numër ... për ndërtimin e shkollës së muzikës “H...”. Sipas kontratës i padituri ka pas për detyre kryerjen e punëve të vrazhda, çmimi i kontratës ka qenë në shumën prej 187,645.00€, ku i padituri NPT [“L...”] ka filluar me ekzekutimin e punimeve gjegjësisht janë bërë gërmime dhe kanë kryer punime në podrumin e shkollës. Si rezultat i kryerjes së punimeve në podrum gjegjësisht gërmimit ka ardhur deri të rrëshqitja e dheut dhe asfaltit ngase shkolla ka qene e planifikuar që të ndërtohet afër trotuarit dhe për pasojë është dëmtuar gypi i ujësjellësit i cili shërben për shpërndarjen e ujit, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e së cilit e benë pala e paditur. Meqenëse e paditura e menaxhon rrjetin e shpërndarjes së ujit me datën 24.07.2016 ka dalë në vend ngjarje dhe e ka bërë sajimin e defektit të shfaqur në gypin e rrjetit të shpërndarjes së ujit. Me datën 30.08.2016 në mesnatë ka ardhur deri të depërtimi i ujit në objekt si rezultat i shpërthimit të gypit të riparuar nga pala e paditur dhe për pasojë objekti ku kanë qene duke u zhvilluar punimet është përfshire nga uji. Nga raportin i ekspertizës së ndërtimtarisë është vërtetuar se është shkaktuar edhe dëm në objekt, ngase objekti është bërë jo funksional dhe në lidhje me këto punime të realizuara pala padiëse të kontraktuarit ia kishte paguar.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 158.2 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së e ka refuzuar kërkesëpadinë e padiësit, dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, pasi ka vlerësuar se nuk ekziston detyrimi i të paditurit për kompensimin e dëmit të pretenduar nga padiësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm lidhur me të gjitha pikat e dispozitivit të aktgjykimin, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, përkatësisht nenin 158 paragrafi 1 të LMD-së me të cilin theksohet se *“Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedhe nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efektit i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet”*. Meqenëse pala padiëse

nuk e ka njoftuar me kohë palën e paditur lidhur me shpërthimin e gypit, pala e paditur nuk ka mundur që të marrë masat e nevojshme në lidhje me riparimin e gypit me kohë, në mënyrë që të parandalohet edhe shkaktimi i dëmit, andaj në këtë rast nuk mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit material për shkak të shpërthimit të gypit të ujësjellësit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e palës paditëse ngase duke u bazuar në provat nga shkresat e lëndës dhe nga ekspertiza e hidroteknikes, rezulton se pala paditëse dhe kontraktuesi NTP ["L..."], me rastin e fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit të punimeve nuk i ka marrë masat e nevojshme në vend punishte në mënyrë që ta parandaloje shembjen e dheut, si pasojë e së cilës ka ardhur edhe deri të dëmtimi i gypit të ujësjellësit. Po ashtu nga dëshmia e dëshmitareve ka rezultuar se pas ndodhjes së rastit nuk është njoftuar me kohë pala e paditur si përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së ujit në mënyrë që të parandaloj dëmin e shkaktuar.

Prandaj, kjo gjykate vlerëson se nuk ekziston obligimi i të paditurës që paditëses t'ia kompensojë dëmin material për shkak të shpërthimit të gypit të ujësjellësit për arsye se është vërtetuar se deri te defekti i gypit ka ardhur për shkak të pakujdesisë së pune kryesit me rastin e ekzekutimit të punimeve, dhe se nuk ka ardhur me lëshimet e të paditurës. Po ashtu ne pala paditëse "Komuna e Pejës" dhe punë kryesi nuk e kanë njoftuar me kohë për shpërthimin e gypit dhe se në këtë rast nuk mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit pasi nuk ekziston lidhja shkakore ndërmjet ndonjë veprimi apo mospërmbushje të detyrimeve të së paditurës dhe dëmit të pësuar, por dëmi është shkaktuar si pasojë e veprimeve të punëkryesit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e palës paditëse lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike,

Ae.nr.98/2020,dt.02.11.2021

KRYETARI I KOLEGJIT,

Mahir Tutuli, d.y.

